



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2177 Prot.

Roskovec, më 26.03 2024

VENDIM

NR 15 .DATË 21.03 .2024

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS DHE
RAPORTIT TË TRANSPARENCËS NË VENDIMMARRJE TË KËSHILLIT TË
BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2023”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe VKB Nr.20 datë 27.03.2020 “Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike” neni 43 i tij, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Miratimin e raportit të punës së Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2023.
2. Miratimin e raportit të transparencës në vendimmarrje të Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2023.
3. Bashkëlidhur këtij vendimi raporti i punës dhe raporti i transparencës në vendimmarrje të Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2023.
4. Ngarkohet Sekretaria e Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7045/1 Prot

Roskovec , më 19.03.2024

Lënda: Raport për punën e Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2023

Të nderuar këshilltarë,

Këshilli i Bashkisë Roskovec i kryen funksionet dhe veprimtarinë e tij duke u mbështetur në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloreve të miratuara nga vet këshilli. Këshilli ka ngritur 10 Komisione të Përherëshme të cilët duhet të mbledhen sipas rasteve që paraqiten për në këshill.

Gjatë vitit 2023 Këshilli është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin një vëmendje më të madhe për një shërbim cilësor dhe sa më afër komunitetit. Në mbledhjet e këshillit janë trajtuar vendime të rëndësishme që kishin një impakt të fuqishëm në lidhje me përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve në qytet dhe fshatra. Prioritare kanë qënë vendimet që i kushtoheshin zgjidhjes së problemeve për familjet në nevojë dhe ato me probleme të thella sociale.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë miratuar gjithësej 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) vendime në Këshillin e Bashkisë Roskovec.

Janë organizuar dhe zhvilluar 15 mbledhje këshilli të cilat kanë qënë të gjitha mbledhje të hapura për publikun. Nga mbledhjet e zhvilluara, 13 kanë qënë mbledhje të radhës dhe 2 mbledhje jashtë radhe me kërkesë të Kryetares së Bashkisë, ku disa prej mbledhjeve të zhvilluara gjatë këtij viti janë transmetuar live në faqen e facebook të këshillit. Njoftimet e mbledhjeve dhe publikimi e afishimi i tyre është bërë sipas kriterëve që përcakton ligji.

Nga 115 vendimet e miratuara në këshill, 25 vendime kanë qënë akte me karakter normativ dhe 90 vendime akte me karakter individual dhe kolektiv. Vendimet të cilat ishin akte me karakter normativ, pra 25 vendime i kemi dërguar në Prefekturën e Qarkut Fier për konfirmimin ligjor, pasi në bazë të ligjit Nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut" neni 16 i tij, Prefekti i Qarkut si kompetencë kryesore në lidhje me NJVQV-të ka verifikimin ligjor të akteve normative. Vetëm 1

(një) Vendim nuk është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier dhe në bazë të procedurës ligjore vendimi i cili nuk është miratuar nga Prefektura, është anuluar po me vendim këshilli. Vendimet me karakter individual dhe kolektiv pas miratimit në Këshillin e Bashkisë, janë zbardhur brenda afateve ligjore nga Sekretaria e Këshillit dhe kanë hyrë në fuqi në bazë të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6 i tij. Të gjitha vendimet e miratuara sipas karakterit dhe objektivit të tyre u janë shpërndarë administratës së bashkisë për zbatim.

Vlen të theksohet se nga kontrolli periodik 3 mujor i institucionit të Prefektit të Qarkut Fier, në lidhje me verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të Këshillit të Bashkisë Roskovec, në përfundim të këtyre kontrolleve të ushtruara çdo 3 muaj gjatë vitit 2023, Prefektura shprehet se :

- Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur akte normative të padepozituara për verifikim tek Prefekti i Qarkut.
- Aktet me karakter normativ kanë qënë të shoqëruara me projektvendimet dhe relacionet përkatëse.
- Procesverbali i mbledhjes mbahet në përputhje me Ligjin Nr.8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Normat Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.
- Procesverbali i mbledhjes paraardhëse miratohet në fillim të mbledhjes pasardhëse në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuar me Vendim Nr.19 datë 27.03.2020.
- Për mbledhjet e zhvilluara është respektuar afati i njoftimit të rendit paraprak të ditës, në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 53, pika 4.
- Gjatë kontrolleve nuk janë konstatuar shkelje të procedurave ligjore.

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar disa mbledhje komisionesh, kryesisht Komisioni i Ekonomisë dhe Buxhetit. Vlen për tu theksuar se Komisionet e Këshillit duhet të funksionojnë dhe të jenë sa më aktive, dhe duhet të mblidhen me inisiativën e tyre për çështjet që trajtohen në këshill, sipas tematikës së çështjes.

Nisur nga karakteri i vendimeve pjesën më të madhe të vendimeve të miratuara për vitin 2023 e zënë vendimet për problemet financiare me 26 vendime; 25 vendime të vet këshillit për miratim procesverbalesh të mbledhjeve, planet e aktiviteteve të punës, raporte të punës dhe transparencës, miratim madatesh dhe komisionesh; 21 vendime për problemet sociale dhe familjeve në nevojë; 14 vendime për infrastrukturën dhe investime; 5 vendime për taksat dhe tarifatat vendore si dhe ndryshime të tyre; 5 vendime për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për lidhje marrëveshje të ndryshme; 4 vendime dhe dhënie tituj nderi dhe statusi dëshmor; 5 vendime miratim planesh të ndryshme; dhe pjesa tjetër e vendimeve janë të problematikave të ndryshme si anulim vendimesh, miratim akte themelimi të ndërmarrjeve, etj.

Këshilli Bashkiak ka të miratuara disa rregullore për funksionimin e punës së tij.

Rregulloret e këshillit përcaktojnë rregullat e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Këshillit Bashkiak Roskovec, procedurën e miratimit të vendimeve të Këshillit, të veprimtarisë vendimarrëse, përfaqësuese dhe mbikqyrëse të Këshillit, monitorimin e procesit të zbatimit të vendimeve të Këshillit, si dhe marrëdhëniet e Këshillit me Kryetarin dhe administratën e Bashkisë, me institucionet, agjencitë qeveritare qendrore dhe rajonale, komunitetin, shoqërinë civile dhe grupet e interesit, si dhe strukturat komunitare, përgjatë ushtrimit të funksioneve dhe realizimin e detyrave të dhëna me ligj.

Një pjesë shumë e rëndësishme gjatë zhvillimit të mbledhjeve të këshillit, është edhe hapsira kohore që i kushtohet komunitetit pjesmarrës në mbledhje. Një pikë e veçantë e rendit të ditës i kushtohet veçanërisht diskutimeve dhe komenteve të qytetarëve, gjatë së cilës dëgjohen problemet dhe hallet e qytetarëve nga këshilli dhe bashkia. Çdo kërkesë dhe problem që këshilltarët apo qytetarët ngrejnë në mbledhjet e këshillit protokollohen nga sekretarja dhe i dërgohen për shqyrtim Kryetares së bashkisë. Kryetarja këto problematika ua drejton drejtorive përkatëse për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.


Nga sa më sipër vlen të theksohet se Këshilli Bashkiak ka trajtuar dhe i ka dhënë zgjidhje një game të gjerë problematikash të komunitetit tonë në fusha të ndryshme si: për familjet në nevojë, për ndihmat ekonomike, për shërbime ndaj komunitetit, për të ardhurat e veta, për fondet buxhetore, investime ndaj komunitetit etj. Zgjidhja e këtyre problemeve vjen si rezultat i një bashkëpunimi shumë të mirë me Ekzekutivin dhe administratën e Bashkisë Roskovec, të cilët kanë si objektiv të përbashkët zgjidhjen në kohë dhe sipas ligjit gjithë shqetësimet dhe problematikat e komunitetit të Bashkisë Roskovec.

Të gjitha vendimet e këshillit janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec. Kjo faqe përditësohet në vazhdimësi me të gjitha informacionet e nevojshme të cilat duhet të publikohen sipas ligjit.

Punë të mbarë për vitin 2024 dhe falenderime për kontributin e secilit prej jush!

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin!

Konc. Sekretar i Këshillit
Arlinda Hajdini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2045/2 prot.

Roskovec, më 19/03/2024

**RAPORTI I TRANSPARENCËS NË VENDIMMARRJE I KËSHILLIT TË
BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2023**

Referuar ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit Nr.146/2014 “Për konsultimin publik”, VKB Nr.20 datë 27.03.2020 “Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike”, Këshilli i bashkisë si organ përfaqësues, vendimmarrës dhe mbikqyrës ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse duke respektuar parimet e demokracisë vendore, të transparencës, për të qënë sa më afër qytetarëve.

Referuar për sa më sipër Këshilli i Bashkisë Roskovec gjatë vitit 2023 ka miratuar 115 vendime në total. Këshilli i Bashkisë Roskovec për vitin 2023 ka zhvilluar në total 30 dëgjesa publike me komunitetin, grupe të interesit si dhe çdo palë tjetër të interesuar.

Dëgjesat publike janë realizuar në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Në dëgjesat publike është vërejtur një rritje e pjesëmarrjes së elementit gjinor femër. Gjatë vitit 2023 në dëgjesa kanë marrë pjesë afërsisht 579 qytetarë, nga të cilët 198 femra dhe 381 meshkuj, të grupmoshave të ndryshme.

Vlen për tu theksuar se vetëm për Paketën Fiskale për vitin 2024 dhe Buxhetin e vitit 2024 Këshilli në bashkëpunim me Bashkinë Roskovec kanë zhvilluar 16 dëgjesa publike. Këto dëgjesa janë zhvilluar në çdo fshat, në çdo lagje ku kanë marr pjesë këshilltarët si përfaqësuesit e këshillit në bazë të fshatit apo lagjes që ata përfaqësojnë.

Në dëgjesat e zhvilluara janë bërë propozime dhe sugjerime shumë të vlefshme, kryesisht për buxhetin dhe paketën fiskale. Këshilli dhe Bashkia kanë vlerësuar sugjerimet dhe propozimet e bëra nga qytetarët dhe janë angazhuar që ato të pasqyrohen në vendimmarrje. Buxheti i vitit 2024 është hartuar dhe miratuar duke përfshirë rekomandimet e bëra gjatë dëgjesave publike.

Mbetet si detyrë mjaft e rëndësishme në të ardhmen gjetja e mënyrave dhe formave të tjera për të komunikuar me publikun, me qëllim pjesëmarrjen sa më aktive në vendimmarrje të komunitetit. Në këtë drejtim edhe strukturat komunitare të cilat janë të ngritura dhe vet këshilltarët duhet të bëhen më aktiv në nxitjen e qytetarëve për të marr pjesë në këto takime.

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përveç ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruara nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës, me rastin e shqyrtimit të gjithë projekt-vendimeve të propozuara nga ekzekutivi, në zbatim të planit të aktiviteteve të vitit 2023, u realizuan dhe u paraqitën në këshill edhe disa informacione dhe raporte nga administrata sipas kërkesave të bëra nga vet këshilli.

Në këtë drejtim, edhe për vitin 2024 në planin e aktiviteteve të miratuara janë planifikuar një sërë informacionesh dhe raportesh nga të cilat një pjesë e mirë janë edhe detyrime ligjore për tu paraqitur nga administrata e bashkisë dhe për tu shqyrtuar nga këshilli.

Nga sa më sipër, duke ju falenderuar secilin për kontributin dhe angazhimin, ftojme të gjithë të bëheni pjesë për përmirësimin e punës së këshillit në vazhdimësi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj !

Konc. Sekretar i Këshillit

Arlinda Hajdini

